



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Zyra e Prokurimit
Dt. 25.10.2024

Në bazë të nenit 72 të Rregullores për Prokurim Publik të dt. 01.11.2022, nenit 28, paragrafi 28.1, nenit 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe kërkesës së menaxherit të kontratës me numër të prokurimit : 632-24-797-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-24-004-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04- 5885, për shkak të pamundësisë së përmbushjes së obligimeve kontraktuale nga ana e Kontraktuesit, në bazë të kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, me dt.25.10.2024, AK Komuna e Gjakovës, respektivisht Zyra e Prokurimit, merr:

VENDIM

Për ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës

1. Për shkak se kontrata "Mirëmbajtja e ndriçimit publik", është kontratë me peshim në të gjitha pozicionet e saj , gjatë realizimit të punimeve sipas kërkesave në vend disa nga pozicionet janë shpenzuar dhe pozicionet e mbetura nuk ka mundësi të realizohen me këtë kontratë pasi janë të ndërlydhura me pozicione tjera të cilat nuk janë të planifikuara ose janë shpenzuar. Në këtë situatë kontrata nuk mund të vazhdoj. Nisur nga ky fakt, kontrata me numër të prokurimit: 632-24-797-1-1-1 dhe numër të brendshëm 632-24-004-111 dhe nr. të protokollit 01nr.410/04- 5885, me titull: "Mirëmbajtja e ndriçimit publik", e lidhur me dt.16.04.2024, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Labinot M.Krasniqi B.I., Glllogoc, Negrofc, **NDËRPRITET ME MARRËVESHJE MES DY PALËVE KONTRAKTUESE.**
2. Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, në pajtim me nenin 28, paragrafi 28.1, nenin 29, paragrafi 29.1, të Kushteve të Përgjithshme të Kontratës (KPK) dhe rekomandimit të Menaxherit të kontratës kanë arritur në përfundim që të bëhet ndërprerja e kontratës me marrëveshje mes dy palëve kontraktuese.
3. Palët janë pajtuar që nuk do të ketë kërkesë për dëmshpërblim nga ana e Kontraktuesit e as penalizim nga ana e Autoritetit kontraktues.

4. Ky Vendim hynë në fuqi dhe zbatohet nga data e marrjes.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës, në cilësinë e punëdhënësit, ka iniciuar aktivitetin për “Mirëmbajtja e ndriçimit publik”, në mes të Komunës së Gjakovës dhe kryesit të punëve Labinot M.Krasniqi B.I., Gllogoc, Negrofc, për kryerjen e punëve të kontraktuara sipas Kontratës.

Menaxheri i Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në zbatim të detyrave dhe përgjegjësi të tija, përmes kërkesës së dërguar në Zyrën e Prokurimit me datë 23.10.2024, ka kërkuar nga Udhëheqësi i zyrës së të Prokurimit ndërprerjen me marrëveshje të Kontratës.

Me datë 24.10.2024, Udhëheqësi i Zyrës së Prokurimit, ka dorëzuar “Njoftimin për shkëputje me marrëveshje të kontratës” të kryesi i shërbimeve Labinot M.Krasniqi B.I., Gllogoc, Negrofc,

Andaj, për arsyet sikurse u theksua në këtë Vendim dhe në pajtim me dispozitat nenit 72 të Rregullave të Prokurimit Publik është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

UDHËZIM JURIDIK :

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues me marrjen e këtij Vendimi ka shkelur Ligjin apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë ankese pranë Gjykatës Themelore – Departamentit për Çështje Ekonomike në Prishtinë, brenda afatit ligjorë të përcaktuar me ligj.

Ardian Gjini

Kryetari i Komunës



Faton Gutaj

Zyrtar përgjegjës i prokurimit

Vendimi t'i dorëzohet:

Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Drejtorisë për Shërbime Publike;
Drejtorisë për Buxhet dhe Financa;
Menaxherit të kontratës;
Arkivës së Komunës.